



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/24

Datë: 14.08.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 gusht 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen procesverbalet dhe transkriptet nga mbledhjet; 9, 12, 14 dhe 15 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Aprovohen procesverbalet nga mbledhjet elektronike\korresponduese\elektronike: 10, 11, 13, dhe 16 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/24

Datë: 14.08.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 gusht 2020, merr këtë:

V E N D I M


1. Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me Përfundimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 07 -P-055 të datës 06.07.2020, jep mendim lidhur me nismën Legjislative për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-064 për festat zyrtare në Republikën e Kosovës.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës e vlerëson nismën legislative të iniciuar nga deputetët propozues të Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-064 për festat zyrtare në Republikën e Kosovës, përmes së cilës krijohet baza ligjore për shënimin e Ditës së Egjiptianëve me 24 qershor, si ditë memoriale.
3. Qeveria e konsideron të nevojshme që ky projektligj duhet të plotësohet dhe ndryshohet edhe në disa nene tjera. Ndryshimet konsistojnë në:
 - 3.1. Neni 3 paragrafi 1 të riformulohet si në vijim:

Në përjashtim të pikës "e" (9 Maji Dita e Evropës), ditët e festave zyrtare të cekura në nenin 2 të këtij ligji janë ditë të lira me pagesë për të gjithë punëtorët e Kosovës, përveç kur është e rregulluar ndryshe me ligje tjera.
 - 3.2. Neni 4, të fshihet në tërësi dhe të riformulohet si në vijim:

"Kur ditët e festave zyrtare të cekura në nenin 2 të këtij ligji bien ditën e shtunë ose të diel, nuk do të jenë ditë pushimi ditët pasardhëse të punës".
4. Vendimi bashkë me tekstin e mendimit nga pika 1. e këtij vendimi i procedohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/24

Datë: 14.08.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 gusht 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me Përfundimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 07 -P-056 të datës 06.07.2020, jep mendim lidhur me nismën Legjislative për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.03/L-256.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës e vlerëson nismën legjislative të iniciuar nga deputetët propozues të Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.03/L-256, megjithatë e konsideron si jo të plotë për të përmirësuar procesin dhe procedurat e organizimit të zgjedhjeve në Kosovë.
3. Qeveria e Kosovës konsideron se nisma e tillë legjislative duhet të adresoj të gjitha çështjet që janë identifikuar si parregullsi gjatë monitorimit të proceseve zgjedhore nga organizatat monitoruese ndërkombëtare dhe vendore.
4. Çështjet e tilla që duhet adresuar:
 - 4.1. **Mbrojtja e të drejtave zgjedhore:**
 - 4.1.1. Sigurimi ligjor dhe kushtetues për kërkesat e kandidatëve për t'u kualifikuar pas vendimit të Gjykatës Supreme për de-certifikimin e kandidatëve;
 - 4.1.2. Qartësimi i kapitullit për ankesat në lidhje me afatet dhe përmbajtjen e nevojshme të ankesave;
 - 4.1.3. Afatet për paraqitjen e ankesave në zgjedhje duhet të zgjasin deri në 48 orë dhe afatet kohore për PZAP për të vendosur mbi ankesat kundër rezultateve të zgjatura deri në 5 ditë;
 - 4.1.4. Ndryshimet ligjore që u mundësojnë PZAP dhe Gjykatës Supreme publikimin në kohën e duhur të parashtrësive, ankesave dhe vendimet në faqet e tyre të internetit;
 - 4.1.5. Të mundësohet hapja e degëve të PZAP-së në shtatë (7) rajone gjatë procesit të zgjedhjeve.

4.2. Administrimi i zgjedhjeve

- 4.2.1. Të zgjatet afati për të paraqitur listën e votuesve dhe periudha e kontestimit, për aplikacionet për votim të personave me nevoja të veçanta, për regjistrim dhe votim jashtë Kosovës, dhe për caktimin e vendvotimit;
- 4.2.2. Të mundësohen afate kohore më të gjata dhe masa shtesë mbrojtëse, në mënyrë që të përmirësohet përfshirja integriteti i procesit të votimit jashtë Kosovës;
- 4.2.3. Të bëhen pjesë përmbajtjesore e ligjit rregullat themelore zgjedhore që aktualisht janë të përcaktuara në rregulloret e KQZ-së, p.sh. për funksionimin e Qendrës Numërimit dhe Rezultateve, rregullat për rinumërim dhe anulime etj.

4.3. Fushata


- 4.3.1. Rregullat e fushatës lidhur me njoftimin dhe organizimin e ngjarjeve politike, rregullat për postime zgjedhore dhe rregullat për përfshirjen e nëpunësve civilë në fushatat zgjedhore duhet të zhvillohen më tej në LZP;
- 4.3.2. Të përcaktohen afate, ku jo më vonë se 30 ditë pas ditës së zgjedhjeve, pjesëmarrësit në zgjedhje duhet të paraqesin raporte financiare.

4.4. Media

- 4.4.1. Duhet marrë në konsideratë rregullimin e programeve të sponsorizuara nga partitë politike ngjashëm me spotet reklamuese politike me pagesë.

5. Vendimi bashkë me tekstin e mendimit nga pika 1. e këtij vendimi i procedohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/24

Datë: 14.08.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 gusht 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim lidhur me Financimin e Programit - Nxitja dhe Levimi i Mundësive për Sigurimin e Ujit.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/24
Datë: 14.08.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 gusht 2020, merr këtë:


V E N D I M

1. Riorganizohet Këshilli Kombëtar për Zhvillim Ekonomik të Kosovës.
2. Ndryshohet emërtimi nga "Këshilli Kombëtar për Zhvillim Ekonomik" në "Këshilli Kombëtar për Ekonomi dhe Investime" (KKEI) (në tekstin e mëtejme "Këshilli")
3. Këshilli përbëhet nga:
 - 3.1. Kryeministri, kryesues;
 - 3.2. Ministri i Ekonomisë dhe Ambientit;
 - 3.3. Ministri i Tregtisë dhe Industrisë;
 - 3.4. Ministrja e Financave;
 - 3.5. Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
 - 3.6. Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale;
 - 3.7. Ministri i Arsimit dhe Shkencës;
 - 3.8. Ministri i Drejtësisë;
 - 3.9. Ministri i Infrastrukturës;
 - 3.10. Ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
 - 3.11. Ministri i Pushtetit Lokal;
 - 3.12. Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës;
 - 3.13. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të Kosovës;
 - 3.14. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Investimeve dhe Përkrahjeve të Ndërmarrjeve në Kosovë;
 - 3.15. Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës;
 - 3.16. Udhëheqësi i Zyrës së Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim në Kosovë (BERZH);
 - 3.17. Udhëheqësi i Zyrës së Bankës Botërore në Kosovë (BB);
 - 3.18. Përfaqësuesi i Posaçëm i Bashkimit Evropian në Kosovë (PPBE)/Komisioni Evropian (KE);
 - 3.19. Ambasada e SHBA-së në Kosovë / Agjencia e SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID);
 - 3.20. Kryetari i Bordit apo Drejtori Ekzekutiv i Odës Ekonomike e Kosovës;
 - 3.21. Kryetari i Bordit apo Drejtori Ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë;
 - 3.22. Kryetari i Bordit apo Drejtori Ekzekutiv i Aleancës Kosovare e Biznesit;

- 3.23. Kryetari i Bordit apo Drejtorja Ekzekutiv e Odës Ekonomike Gjermano – Kosovare;
 - 3.24. Kryetari i Bordit apo Drejtori Ekzekutiv i Odës së Afarizmit të Kosovës;
 - 3.25. Kryetari i Bordit apo Drejtori Ekzekutiv i Këshillit të Investitorëve Evropian;
 - 3.26. Kryetari i Bordit apo Drejtori Ekzekutiv i Klubit të Prodhuesve të Kosovës;
 - 3.27. Kryetari i Bordit apo Drejtori Ekzekutiv i Forumit Ekonomik të Grave;
 - 3.28. Kryetarja e Bordit apo Drejtori Ekzekutiv i Dhomës Ekonomike të Grave të Kosovës – G7;
 - 3.29. Kryetari i Bordit apo Drejtorja Ekzekutiv e Shoqatës së Përpunuesve të Drurit;
 - 3.30. Kryetari i Bordit apo Drejtori Ekzekutiv i Asociacionit të Komunave të Kosovës.
4. Kryeministri mund të ftojë edhe anëtarë në mbledhjet e Këshillit, të cilët marrin pjesë në diskutim pa të drejtë vote.
 5. Këshilli ka fushë-veprimtari që të:
 - 5.1. Promovon dialogun midis Qeverisë dhe sektorit privat në hapat e nevojshëm në adresimin e çështjeve më të ngutshme për zhvillimin e sektorit privat dhe përmirësimin e klimës së biznesit në përgjithësi dhe nxitjen e investimeve vendase dhe të huaja;
 - 5.2. Identifikon pengesat kryesore të mjedisit të biznesit në sektorë të ndryshëm të ekonomisë dhe propozon masat për përmirësimin e mjedisit të biznesit dhe klimës së investimeve;
 - 5.3. Propozon dhe ofron këshilla për prioritetet strategjike të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe projekte të tjera të zhvillimit, në përputhje me praktikatat më të mira ndërkombëtare;
 - 5.4. I propozon Qeverisë ligje dhe akte nënligjore që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e mjedisit të biznesit;
 - 5.5. Bën propozime të mbështetura nga ekspertiza profesionale juridike dhe ekonomike me qëllim të ndryshimit dhe/ose përmirësimit të legjislacionit rregullator për biznesin;
 - 5.6. Miraton planet operative për përmirësimin e mjedisit të investimeve;
 - 5.7. Inicion konsultime dhe bashkëpunim me investitorët potencialë strategjikë;
 - 5.8. Paraqet para Qeverisë raportet për zbatimin e planit operacional për mjedisin e biznesit;
 - 5.9. Bashkëpunon me organizata dhe institucione ndërkombëtare në lidhje me shkëmbimin e përvojave dhe rekomandimeve për përmirësimin e mjedisit të biznesit;
 - 5.10. Përgatit analiza mbi mundësitë e zhvillimit dhe avantazhet krahasuese të Kosovës;
 - 5.11. Fuqizon rolin e komunitetit të biznesit në procesin e zhvillimit ekonomik të vendit;
 - 5.12. Monitoron zbatimin e Programit Qeveritar sa i përket zhvillimit ekonomik;
 - 5.13. Sipas nevojave dhe në përputhje me procedurat respektive, angazhon specialistë për kryerjen e vlerësimeve për përmirësimin e klimës së biznesit.
 6. Obligohet Sekretariati i Këshillit të përgatisë Rregulloren për Punën e KKEI, e cila miratohet nga Këshilli.
 7. Punët profesionale, analitike, teknike dhe administrative të Këshillit i kryen Sekretariati i Këshillit.
 8. Ky vendim shfuqizon Vendimin e Qeverisë nr. 05/24 të datës 17 prill 2015, Vendimin e Qeverisë nr. 07/115 të datës 09 nëntor 2016, Vendimin e Qeverisë nr. 08/70 të datës 15 janar 2016, Vendimin e Qeverisë nr. 16/21 të datës 22 dhjetor 2017, si dhe Rregulloren Nr. 01/2015 për punën e Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik të Kosovës.

9. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/24
Datë: 14.08.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 gusht 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës merr përsipër mbulimin e primit të policës së sigurimit kufitar për të gjithë bashkatdhetarët dhe të huajt që hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës.
2. Qeveria subvencionon primin e policës së sigurimit një (1) mujor të lëshuar brenda periudhës 01.08.2020 dhe 31.12.2020.
3. Obligohet Ministria e Financave, Ministria e Punëve të Brendshme, Banka Qendrore e Kosovës dhe Byroja Kosovare e Sigurimeve të zbatojnë këtë vendim në përputhje me kushtet e Marrëveshjes së Bashkëpunimit me datë 29.07.2020.
4. Themelohet Grupi Punues ndërinstitucional për ndërmarrjen e masave të duhura për përgatitjen e kushteve për aplikim në kartonin e gjelbër, me këtë përbërje:
 - 4.1. Ministria e Punëve të Brendshme, kryesues;
 - 4.2. Ministria e Financave - anëtar;
 - 4.3. Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës - anëtar;
 - 4.4. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës - anëtar; dhe
 - 4.5. Byroja Kosovare e Sigurimeve, anëtar
5. Obligohet Ministria e Financave që mjetet për zbatimin e këtij vendimi t'i siguroj nëpërmjet ndarjeve përkatëse buxhetore të përcaktuara me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës, shpenzime të cilat më pas kompensohen nga ndarja buxhetore për rimëkëmbje ekonomike.
6. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve të Brendshme, Banka Qendrore e Kosovës dhe Byroja Kosovare e Sigurimeve për zbatimin e këtij vendimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- BQK-së
- BKS-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/24

Datë: 14.08.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 gusht 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti mbi nivelin e ekzekutimit të projekteve të financuara nga huamarrja ndërkombëtare për projektet të cilat kanë nivel të ultë të zbatimit, me rekomandimet përkatëse për adresimin e sfidave të identifikuar.
2. Obligohen të gjitha institucionet publike zbatuese të projekteve të financuar nga huamarrja ndërkombëtare që të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për dinamizmin e nivelit të zbatimit të projekteve nga huamarrja dhe të adresojnë në mënyrë efektive të gjitha pengesat për zbatim në koordinim me Ministrinë e Financave.
3. Obligohen të gjitha institucionet publike nga pika 2. e vendimit që të raportojnë në baza tremujore lidhur me nivelin e zbatimit të projekteve dhe veprimet e ndërmarra për të adresuar sfidat e paraqitura në periudhën raportuese.
4. Obligohen Thesari i Kosovës dhe Ministria e Financave që dy herë në vit të paraqes për shqyrtim në Qeveri një raport përmbledhës të projekteve të huamarrjes ndërkombëtare me rekomandimet përkatëse për zbatimin e tyre, sipas pikës 1. të këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/24

Datë: 14.08.2020

Në mbështetje të nenit 55, dhe 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 89 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, të Ligjit Nr. 02/L-109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjithëse, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, më qëllim të zbatimit të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/11, datë 15.03.2020, për Shpalljen e Emergjencës për Shëndetin Publik, Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, 01/17 të datës 28.07.2020, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 gusht 2020, merr këtë:

V E N D I M


Për hapjen e Kufijve Shtetëror të Republikës së Kosovës

1. Ndryshohet dhe plotësohet pika 5. e Vendimit të Qeverisë nr. 02/38, të datës 31 maj 2020 dhe pika 1. e Vendimit 06/05 të datës 15 qershor 2020, të datës 15 qershor 2020, si në vijim:
 - 1.1. Përveç pikave kufitare të përcaktuara në Vendimin nr. 02/38 të datës 31 maj 2020 dhe Vendimin 06/05 të datës 15 qershor 2020, të datës 15 qershor 2020, hapen kufijtë tokësor edhe për këto pika :
 - 1.1.1. Pikat e Kalimit të Kufirit me Republikën e Shqipërisë:
 - Pika e Kalimit të Kufirit në Shishtavece;
 - Pika e Kalimit të Kufirit në Orqush;
 - Pika e Kalimit të Kufirit në Borje.
 - 1.1.2. Pikat e Kalimit të Kufirit me Republikën e Maqedonisë së Veriut:
 - Pika e Kalimit të Kufirit në Glloboqic;
 - Pika e Kalimit të Kufirit në Stanqiq.
 - 1.2.3. Pika e Kalimit të Kufirit me Republikën e Serbisë:
 - Pika e Kalimit të Kufirit në Bërnjak.
2. Obligohen të gjitha institucionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës të ndërmarrin veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi konform vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ar sy e t i m

Meqenëse me Vendimin e Qeverisë nr. 01/17 të datës 28.07.2020, pika (1) është përcaktuar se të gjithë qytetarët e Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi, Serbisë dhe Bosnjës dhe Hercegovinës, të cilët hyjnë në territorin e Republikës së Kosovës duhet të dëshmojnë se janë të shëndoshë nga COVID-19, me testin RT-PCR në Sars COV-2, sipas parimit të reciprocitetit, në këtë mënyrë kanë pushuar arsyet që pikat e kalimit kufitar si në pikën 1. të këtij vendimi të qëndrojnë të mbyllura.

Avdullah HOTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/24

Datë: 14.08.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 gusht 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për themelimin e Agjencisë për Integrim Evropian.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/24

Datë: 14.08.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 gusht 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Sëmundjet Ngjitëse.
2. Obligohet Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/24
Datë: 14.08.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 07/L-014 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 gusht 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen kriteret për financim të projekteve të komunave nga programi komunal për zhvillim të infrastrukturës socio-ekonomike.
2. Obligohet Ministria e Pushtetit Lokal, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/24

Datë: 14.08.2020

Në mbështetje të nenit 55 dhe 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në zbatim të nenit 89 dhe nenit 90 të Ligjit nr. 04/L-125 për Shëndetësi si dhe në zbatim të dispozitave të Ligjit nr. 02/L-109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, si dhe në zbatim të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/11 datë 15.03.2020 për shpalljen e emergjencës për shëndetin publik, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 gusht 2020, merr këtë:


V E N D I M

1. Autorizohet Ministri i Shëndetësisë për plotësim - ndryshimin e Udhëzimit Administrativ 08/2017 - Organizimi, struktura, përcaktimi i shërbimeve dhe veprimtarisë së Institucioneve të Kujdesit Parësor Shëndetësor duke tejkalluar të gjitha procedurat që përcaktohen me Rregulloren nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Rregulloren nr.13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar.
2. Plotësimi - ndryshimi i këtij akti nënligjor përfshin vetëm përcaktimin e kushteve/kritereve specifike për të kryer testime serologjike për Covid -19 në institucionet e kujdesit parësor shëndetësor.
3. Gjatë hartimit të plotësim - ndryshimit të Udhëzimit Administrativ 08/2017 - Organizimi, struktura, përcaktimi i shërbimeve dhe veprimtarisë së Institucioneve të Kujdesit Parësor Shëndetësor, Ministria e Shëndetësisë duhet ta ketë parasysh Ligjin nga i cili derivon Udhëzimi Administrativ si dhe standardeve për hartimin e akteve normative të parapara me Udhëzimin Administrativ nr. 03/2013 për Standardet e Hartimit të Akteve Normative.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Duke ju referuar kërkesave në rritje për testim për COVID 19 në Kosovë si dhe kapaciteteve të limituara të IKShPK-së për diagnostikë serologjike për COVID 19, me qëllim që ky shërbim të jetë sa më i qasshëm për qytetarët e Kosovës, IKShPK rekomandon Ministrinë e Shëndetësisë që t'iu ofroj mundësinë edhe institucioneve të kujdesit parësor shëndetësor në Kosovë të testojnë për prani të antigjeneve të SARS-CoV 2 ose të antittrupave ndaj SARS-CoV 2, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Avdullah HOTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë